



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	02.06.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPINGHOK	3229/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.397/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.397/2022 të datës 19.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.397/2022 e datës 19.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 06/KA i datës 21.03.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 12.10.2021 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: MD/SHKK/03/12.10.2021 për vendin e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, dhjetë (10) pozita, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

I pakënaqur me pikët e arritura në intervistën me gojë, ankuesi me datë 14.02.2022 ka parashtruar kërkesë për rivlerësim në Komisionin Përzgjedhës. Ky i fundit me datë 15.02.2022 ka nxjerrë Vendim me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit si të pa bazuar sepse sipas komisionit vlerësimi i ankuesit në intervistën me gojë është bërë në pajtim me rregulloren në fuqi.



Kundër Vendimit të datës 15.02.2022 të Komisionit Përzgjedhës, ankuesi me datë 22.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 06 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili me datës 21.03.2022 me Vendimin me numër 06/KA, dhe ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 06/KA të datës 21.03.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 19.04.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 2203/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk është bazuar në gjendjen faktike sepse i njëjti pretendon se ka dhënë përgjigje të sakta në intervistën me gojë, mirëpo sipas ankuesit Komisioni Përzgjedhës ka qenë i padrejtë dhe jo real në vlerësimin e tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli, me datë 11.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, si dhe provat nga përgjigja e datë 19.04.2022 sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi H.Xh për të njëjtën procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 19.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 15.02.2022 i Komisionit përzgjedhës i rishqyrtimit të intervistës me gojë; Ankesa e ankuesit e datës 22.02.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi me numër 06/KA i datës 21.03.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi i datës 24.02.2022 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave; Raporti i datës 16.02.2022 për konkursin për zyrtar korrektues; Testi me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën me numër të referencës MD/SHKK/03/12.10.2021; Lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar intervistën në QP Prishtinë; Lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin fizik me datë 06.02.2022; Lista preliminare e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin me shkrim për pozitën zyrtar korrektues; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 29.12.2021; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 26.11.2021 për emërimin e komisionit përzgjedhës; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 14.01.2022; Konkursi i datës 12.10.2021; Vendimi i datës 11.10.2021 për shpallje të konkursit; Kërkesa për fillimin e rekrutimit (Form.MAP-SHCK-01) e datës 07.10.2021; Kërkesa për aprovim të buxhetit e datës 11.10.2021; Vendimi i datës 28.01.2022 i Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Korrektues; Vlerësimet individuale të kandidatëve; Aplikacioni i ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur me dokumentacionin e bashkangjitur; Provat shtesë të ankuesit të datës 13.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe prova shtesë nga organi i punësimit i datës 17.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar *sepse:*





Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë dhe si rrjedhojë marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit të veçantë, respektivisht Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Sipas dispozitave të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rregullimi me ligj të veçantë duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me ligjin për zyrtarët publikë dhe mund të rregullohen ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimi profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Shërbimi Korrektues i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës, me datë 12.10.2021 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: MD/SHKK/03/12.10.2021 për vendin e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, dhjetë (10) pozita.

Sipas konkursit me numër reference MD/SHKK/03/12.10.2021 i shpallur me datë 12.10.2021, për pozitën "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, dhjetë (10) pozita, si kërkesa të përgjithshme janë përcaktuar, si vijon:

- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm, përkatësisht të mesëm të lartë;
- Të jetë i moshës 18-33 vjeçar (deri në datën e mbylljes së konkursit).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë të punës ka aplikuar edhe ankuesi dhe i njëjti ka marrë pjesë përveç testit me shkrim, edhe në testimin me gojë ku në këtë fazë të testimit ka arritur t'i mbledh vetëm 40.2 pikë. Ankuesi nuk ka vazhduar me fazat tjera të testimit sepse nuk kishte arritur piket e mjaftueshme në testimin me gojë, siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës, përkatësisht nenin 16 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Kandidati duhet të arrijë së paku një rezultat prej gjashtëdhjetë (60) nga njëqind (100) poena të mundshme për të vazhduar më tutje me procesin e konkurrimit.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Përzgjedhës ka qenë i padrejtë dhe jo real në procesin e vlerësimit në intervistën me gojë, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës nuk ka arritur të konstatojë ndonjë parregullsi me rastin e vlerësimit të ankuesit nga Komisioni Përzgjedhës gjatë intervistës me gojë, përkatësisht Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në intervistën me gojë ka rritur ti mbledhë vetëm 40.2 pikë, e të cilat nuk janë të mjaftueshme që ankuesi të vazhdojë me tej me fazat tjera të testimit, andaj mbi këtë bazë rrjedhë së Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës, kështu që edhe pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Nisur nga te gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër të protokollit 06/KA të datës 21.03.2022, ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.13/2018 për procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.


Andaj pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.397/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

